

FJALA E DEPUTETIT EDI PALOKA

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

Unë, në fakt, nuk kam kërkuar 10 minuta sot, por vetëm pak minuta, sepse nuk kam ndër mend të debatoj për këtë paçavuren që iu paraqitet shqiptarëve për herë të tretë si program qeverisës. Jam këtu për të thënë, në fakt, se nuk kemi më çfarë të themi këtu. Çfarë vlere kanë më fjalët me këta?! Çfarë vlere kanë fjalët këtu?! Çfarë vlere kanë fjalët me këtë Kryeministër?! Çfarë kemi lënë pa ju thënë në 8 vjet?! Çfarë do t'ju themi? Që janë të korruptuar?! A ka shqiptar që nuk e di më? Edhe fëmijët e dinë. Do t'u themi që janë të lidhur me krimin? E ka marrë vesh e gjithë bota mbarë. Do t'i themi Ramës se është antishqiptar? E ka për mburrje. Mburret! U mburr edhe sot me atë. Do t'i themi që është johuman, çnjerëzor?! Thjesht do të gajaset, siç ka bërë gjithmonë, kur këtu janë ngritur hallet dhe problemet e njerëzve. Çfarë do t'i themi? Ato që i kemi thënë dhe që i meriton të gjitha, madje meriton shumë më tepër?! Që është mashtrues, arrogant, i pafytyrë, dështak; të gjitha të zezat i ka! Do t'ia themi prapë?! Nuk i bëjnë përshtypje. E dëgjuat prapë sot. Nuk e di. Shpresoj që nuk e kishte njeri iluzionin nga kolegët e mi se Rama do të ndryshonte vërtet, se ky parlamenti ku kemi ardhur sot do të jetë ndryshe nga ai i 8 vjetëve, se këta do të zbatojnë rregullat, se na ka shtrirë dorën! E di që nuk e beson njeri nga ne. Por atëherë çfarë do të bëjmë këtu? Çfarë do t'u themi më këtyre? Çfarë vlere kanë më fjalët këtu?! A kemi lënë skandal pa denoncuar në 8 vjet, ministër, qeveritarë, hajdutë të kësaj administrate pa demaskuar?! Asnjë s'kemi lënë. Atëherë, çfarë do të bëjmë? Çfarë do t'u themi? Do të vazhdojmë të flasim, të flasim ne, të flasim këta?!

Këta edhe në këtë moment që ne jemi këtu, janë duke vjedhur! Para 25 prillit nuk e gjeje një socialist të ndershëm, dinjitoz që të kishte guximin ta mbronte këtë Kryeministër. Ulin kokën në rastin më të mirë. Po flas për socialistët, jo për qytetarët e tjerë. Është Kryeministri, pa dyshim, më i urryer ndërshqiptarë! Megjithatë, erdhi 25 prilli, i bleu votat, manipuloi zgjedhjet dhe sot na del prapë aty. Atëherë, çfarë do të bëjmë, do të vazhdojmë të flasim? Prandaj, unë kam një fjalë vetëm për ata shqiptarë që nuk e shesin votën për një qese me ushqime: në qoftë se ju dhimbset liria, megjithëse këtu liria e ka humbur të gjithë kuptimin e saj, por, në qoftë se ju dhimbset familja juaj, e ardhmja e fëmijëve tuaj, ngrihuni luftoni për to! Ngrihuni luftoni! Ndryshe, hajdeni të ulim kokën të gjithë, të pranojmë të vazhdojmë të poshtërohemi e t'i nënshtrohemi një bande perversësh, horrash, hajdutësh e kriminelësh! Të pranojmë të kthehemi në një tufë skllëvëris dhe të ulim kokën! Boll më me justifikime!

Mos u fshihni pas dobësive të opozitës! Mos luftoni për ne, luftoni për vete! Mos u ngrini për karriget tona, ngrihuni për vete! Dhe, në qoftë se nuk keni guxim të ngriheni për vete, ngrihuni të paktën për fëmijët tuaj! Po nuk e shporrët këtë bandë, ky vend do të shkojë keq e më keq! Faleminderit!